



Sugjerime dhe truke për temën...

Faza e ko- këfortësisë

Rebelimi është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e personalitetit.

Faza e kokëfortësisë

Rebelimi është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e personalitetit.

Vullneti i vet zgjohet – ai tregon në formë të reagimeve të kokëforta dhe të thirrjes JO. Fëmija nuk drejtohet në plan të parë kundër jush. Përkundrazi, ai vuan nga pamjaftueshmëria e vet,

- sepse ai ndesh vazhdimisht kufijtë e veta.
- sepse ai dëshiron të bëjë shumë gjëra që nuk mund ose nuk lejohet që t'i bëjë.
- sepse prindërit vendosin rregulla dhe caktojnë kufi.

Ju mund të bëni këtë:

- Qëndroni të qetë.
- Përpiquni që t'ia tërhiqni vëmendjen fëmijës suaj.
- Mbahuni fort pas rregullave dhe kufijve në fuqi.
- Mos kërcënoni me ndëshkim.
- Shpesh herë ndihmon një «Jo» e qartë.
- Shpjegime janë me kuptim vetëm atëherë, kur kriza e kokëfortësisë ka mbaruar dhe fëmija mund të dëgjojë përsëri me vëmendje.
- Mos e ndëshkoni fëmijën tuaj.
- Një ndarje e shkurtër hapësinore ndihmon që të gjendet përsëri qetësi.

Meqë ra fjala:

Një fëmijë është tepër i aftë për të mësuar! Nëse ju u nënshtroheni shpesh krizave të kokëfortësisë, ai do të verë në punë gjithnjë dhe më shumë zemërim, për të arritur diçka – edhe pas fazës së mirëfilltë të kokëfortësisë.

Früherziehungsdienst des Kantons Bern FED

Geschäftsstelle, Frankenstrasse 1, 3018 Bern

Telefon 031 869 18 78, info@fed-be.ch, www.fed-be.ch